

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ME SELI NË TIRANË
TIRANA AGRIKULTURE SH.P.K.

Sot, më datë 15.07.2020 (dymijë e njëzet), Ortaku themelues:

- **BASHKIA TIRANË**, person juridik publik, organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me adresë të regjistruar Sheshi "Skenderbej", Ndertesa 2, 1001, Tiranë, Shqipëri.

vendosi themelimin e shoqërisë "**TIRANA AGRIKULTURE**" Sh.p.k. përmes këtij akt-themelimi

NENI 1

Shoqëria Tregtare **TIRANA AGRIKULTURE Sh.p.k.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "sh.p.k.').

Ortakët e shoqërisë ("Ortakët") gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë.

Ortakët mund të kryejnë në bazë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, financime për llogari të shoqërisë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e zotëruar në kapital, mbulimin e humbjeve ashtu edhe për financime jo fitimprurëse.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **TIRANA AGRIKULTURE Sh.p.k.**

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt veprimtarie:

- Ofrimin e shërbimeve të ndryshme në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit.
- Ngritja, funksionimi dhe menaxhimi i tregut me shumicë dhe pakicë të produkteve bujqësore, blegtorale, të agropërpunimit dhe të akuakulturës.. Krijimin dhe administrimin e strukturave laboratorike për kryerjen e analizave të prodhimeve bujqësore e blegtorale

ERKLA ELTOCI
(gu/bj)

C. U.

si dhe krijimin e strukturave të përshtatshme për kultivimin dhe përdorimin e fushave eksperimentale të prodhimeve bujqësore.

- Dhënia me qira e hapësirave dhe ambienteve personave fizikë dhe juridikë që tregtojnë prodhime dhe ofrojnë shërbime të ndryshme në fushën e bujqësisë, blegtorisë, agropërpunimit dhe gastronomisë. Nxitja e shitjes, organizimi i panairove, ekspozitave dhe promovimi i prodhimeve lokale.
- Veprimtari në fushën e marketingut të prodhimeve bujqësore, blegtorale, agropërpunimit dhe shpërndarja e prodhimeve dhe shërbimeve të siguruara prej saj ndaj të tretëve.
- Veprimtari në fushën e mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve, kooperativave bujqësore dhe organizmave të tjera të vendit të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me sektorët e agrokulturës, agroindustrisë, agroturizmit, mjedisit, etj. Veprimtari si administrues i tregjeve të prodhimeve bujqësore, blegtorale e të agropërpunimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Të ushtrojë veprimtarinë e ndërmjetësimit apo të lidhjes së kontratave ndërmjet personave fizik apo juridik, publik, shtetëror e privat vendas e të huaj në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj.
- Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria mund të hapë njësi menaxhuese, magazinuese, shërbim tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizik e juridik vendas dhe/ose të huaj.
- Të kryejë të gjitha llojet e aktiviteteve tregtare me qëllim realizimin e veprimtarive të përshkruara me sipër.
- Të kryejë Investime për prodhimin, grumbullimin, përpunimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore e blegtorale.
- Të hartojë plane biznesi e fizibilitetit të investimeve në ekonomi si dhe të menaxhojë projekte në bujqësi, industri, tregti, etj.
- Marrja/dhënia me qira e pasurive të paluajtshme; mund gjithashtu të kontribuojë, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi por gjithmonë me qëllimin e vetëm për arritjen e objektit të shoqërisë, me pjesëmarrje dhe interesa në shoqëri të tjera dhe kompani me objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të.
- Pjesëmarrja në shoqëri ekzistuese ose që do të krijohen në të ardhmen, me qëllim krijimin e subjekteve ligjore, me qëllime të njëjta apo të ngjashme. Kryerjen në përgjithësi të të gjitha aktiviteteve industriale, tregtare, financiare, civile, të luajtshme ose të paluajtshme, që mund të lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë ose me objekt të ngjashëm apo të përafërt. Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për qëllimin e shoqërisë.
- Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të nevojshme të lëshuara nga organet kompetente të fushës.
- Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut dhe në ligj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

- Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Sheshi "Skenderbej", Ndertesa 2, 1001, Tirane, Shqipëri.

EMMA ELEXY
G.M. TW

C U .

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i Ortakut themelues të Shoqërisë. Kontributi në para do të ketë një vlerë nominale të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë, i ndarë në një (1) kuotë e zotëruar nga Ortaku i vetëm.

Ortaku themelues i Shoqërisë tregtare "TIRANA AGRIKULTURE" Sh.p.k. zotëron kuotën në shoqëri si më poshtë:

- Bashkia Tiranë, në cilësinë e Ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë.

Kapitali themeltar është derdhur në total nga Ortaku themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortaku me miratimin e këtij Akti.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është I pa përcaktuar dhe mund të ndryshohet një ose disa herë me vendim të Asamblesë së Ortakëve

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm/ Ortakëve – organi më i lartë vendim-marrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë:

- Z. Ermal Elezi, shtetas shqiptar, lindur në Cërrik, më 29.05.1984 dhe me vendbanim në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. 033629013 dhe me Nr. Personal I40529062A.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përrputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

Ermal Elezi
adm. sh.

[Signature]

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga Ortaku i Vetem/ Ortakët themelues. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

NENI 12

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë aktivitetit të shoqërisë zgjidhen me konsensus, në të kundërt palet i drejtohen gjykates kompetente.

NENI 13

Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në katër kopie të njëjta në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga:

Kryetari

Erion Veliaj

21841/2 P.207

Dt 15.07.20



EMMEL ELEMI
G.M. TW